

Sindikatat e Ballkanit Perëndimor dhe integrimi në EU

Vizitë studimore e organizuar nga Programi Njerëzit për Njerëz të Komisionit Evropian në bashkëpunim me ETUC

**Bruksel
8-11 korrik 2013**

Qellimi i përgjithshëm i projektit:

Programi P2P ka për qëllim të ofrojë shoqëri civile nga beneficuesit mundësi për të reaguar dhe për të krijuar një rrjet të nivelit nacional, regional dhe Evropian dhe të krijojë një partneritet të ri si dhe të vizitohen institucionet e EU, në mënyrë që të familjarizohen me strukturat e EU, procesin e krijimit të politikave, programeve, dhe praktikave me të mira.

Ky aktivitet, propozohet nga Konfederata Evropiane Sindikale, është njëri nga 4 workshopet e propozuara të cilat do të mbahen në mes të viteve 2013 / 2014 me qëllim që të perkraken organizatat sindikale nga Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, BiH dhe Kosova të cilat do të marrin pjesë në “aktivitetin e përbashkët të Integritimit në Komisionin e EU” për të arritur kështu standardet Evropiane. Jo do të mundësojë sindikatave të luajnë një rol në proceset e integritimit Evropian si partnerë relevant për qeveritë e tyre përkatëse dhe Komisionin e EU.

Ky projekt ka për qëllim fuqizimin e kompetencave të konfederatave sindikale duke krijuar 5 grupe punuese të cilat do të merren me 5 qëstje/tema të ndryshme (profilii caktuar për një grup target / pjesëmarrësit):

- Zhvillimin e Dialogut Social (grupet target : sindikalistët në krye të Dialogut Social / negociatat)
- Ligjin e Punës dhe të drejtat e punëtorëve / Këshillet Evropiane të Punëtorëve (grupet target: ekspertët ligjor sindikal)
- Legjislacioni për Mbrojtje dhe Shëndet në Punë (grupet target: ekspertë sindikal në krye të OSH – mbrojtjes dhe sigurisë në punë)
- Tregu dhe ekonomia e EU, lëvizja e lirë e tregut (ekonomist të sindikatave / ekspertë të tregut të punës)
- Lufta kundër korrupsionit dhe qeverisjes së mirë (krijim i rrjetit bashkëpunim me përfaqësues të Transparency International – Transparenës Ndërkombëtare)

Qëllimi i këtij workshopi regional është që tu jipet pjesmarrësve mundësia që të familjarizohen me politikat dhe programet e EU lidhur me temat: dialogu social dhe ligji i punës që shtjet shtetërore në proceset e integrimit në shtetet përkatëse.

Workshopi do të bëjë thirrje ekspertëve nga disa organizata nga shtetet e ish Jugosllavisë të cilat e kanë mbaruar procesin e integrimit ne EU dhe që janë në gjysmë të rrugës së këtij procesi. ETUC do të sigurojë që do të ketë kontibut nga ekspertë 'lokal' nga Sllovenia dhe Kroacia.

Vizitë studimore për pjesmarësit do të ketë Serbi, Maqedoni, Mal të Zi, BiH dhe Kosovë. Pjesmarrësit e projektit do të jenë sindikalist nga këto organizata:

- BiH: SSBiH/FbiH (Confederation of Trade Unions of Bosnia and Herzegovina) and SSRS/RS (Serb Republic Trade Unions)
- FYROM: SSM (Federation of Trade Unions of Macedonia) and KSS (Confederation of Free Trade Unions)
- Kosovo: BSPK
- Montenegro: SSCRG and USSM (Union of Free Trade Unions of Montenegro)
- Serbia: SSS and UGS Nezavisnost

Në kuadër të këtij projekti u zhvillua edhe kjo vizitë studimore në Bruksel ku përfaqësues të BSPK ishin: Haxhi Arifi, kryetar i BSPK-së, Dafina Mehaj Zyrtare për Marrëdhënie Ndërkombëtare, Valdet Hajdini, zyrtar ligjor, Ali Vitija, nënkryetar i Sindikatës së Doganave të Kosovës.

U shtjelluan tema të ndryshme nga ligjërues të ndryshëm siq janë:

- Roli i Konfederatës Sindikale Evropiane, nga Bernadette Segol, Sekretare Gjenerale ne ETUC,
- Dialogu Social Evropian dhe politikat e ETUC, Patrick Itschert
- Dialogu Social Evropian dhe roli i shoqatave të punëdhënësve, Peter Seideneck ETUC
- Dialogu Social në BE – Koncepti, Historia, Metodrat dhe Rezultatet, Pavle Vrhovec, Slloveni
- Legjislacioni Evropian i Punës, Komisioni BE-se dhe expert slloven
- Dialogu Social Industrial dhe Marrëdhënit e Punës në sistemin belg, CSC, FGTB dhe CGLSB, përfaqësues të tri Konfederatave Belge

Në kuadër të këtij projekti u realizua edhe vizita në Komisionin Evropian ku përfaqësues të shteteve të Ballkanit Perëndimor realizuan takime te vecanta me zyrtarë të BE për Zgjerim ku u diskutua për rishikimin e procesit të integrimit të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe u diskutuan specifikat e përgjithshme.

Raport i përgatitur nga:

Dafina Mehaj,

Zyrtare për Marrëdhënie Ndërkombëtare, BSPK